


# BULETIN



TETOR 2024



## BRENDA KËTIJ NUMRI

- Kampet e të rinjve në mbarë Kosovën
- Konsultimet mbi Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Konferenca Rinore për Angazhimin për të Drejtave të Njeriut
- Punëtori për drejtësinë mjedisore
- Partneritetet dhe iniciativat
- Deklarata për medie

### KAMPET E TË RINJVE NË MBARË KOSOVËN

Dy kampe rinore u mbajtën këtë muaj në kuadër të projektit "Rinia e Fuqizuar përmes Shkollave dhe Shoqërive Gjithëpërfshirëse (YESS)", financuar nga Fondi i OKB-së për Ndërtimin e Paqes dhe zbatuar nga UNICEF dhe IOM.

4-6 tetor 2024, Bogë, Pejë:: Kampi i parë angazhoi të rinjtë e moshës 13-18 vjeç në sesione gjuhësore interaktive në gjuhën shqipe dhe serbe, duke përdorur metodologjinë VOCUP. Pjesëmarrësit shijuan ushtrime për ndërtimin e ekipit, vizituan Patriarkanën e Pejës dhe u lidhën përmes lojërave shoqërore, nxitjes së miqësisë dhe vlerësimit të ndërsjellë kulturor.





18-20 tetor 2024, Graçanica/Graçanicë: Nga data 18 deri më 20 tetor 2024, në Graçanicë u mbajt kampi rinor që mbledhi të rinj nga komunitete të ndryshme në Hotel Ulpiana, për një program dinamik tre-ditor të fokusuar në përmirësimin e aftësive gjuhësore dhe nxitjen e mirëkuptimit të ndërsjellë. Kampi, në kuadër të projektit "Të rinjtë e fuqizuar përmes shkollave dhe shoqërive gjithëpërfshirëse (YESS)" dhe i organizuar me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), ofroi një mundësi unike për të rinjtë për t'u lidhur dhe mësuar.



18-20 tetor 2024, Graçanicë: Kampi përfshinte sesione të ndryshme interaktive, duke përfshirë punëtorë gjuhësorë nga VOCUP, ku pjesëmarrësit praktikuan aftësitë e komunikimit në serbisht dhe shqip për të promovuar përfshirjen dhe shkëmbimin kulturor. Përveç kësaj, trajnimi për ndihmën e parë i pajisi pjesëmarrësit me aftësi themelore për shpëtimin e jetës, ndërsa një vizitë edukative në lokalitetin arkeologjik të Ulpianës mundësoi eksplorimin e historisë së pasur të rajonit.





## KONFERENCA RINORE PËR ANGAZHIMIN PËR TË DREJTAT E NJERIUT



ACDC mbajti konferencën rinore në Mitrovicën e Veriut më 23 tetor, e fokusuar në promovimin e angazhimit të të rinjve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Paneliste ishin Ivana Rakiq nga Qendra “Podrži me” dhe Miljana Vuçinić nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Konferenca vuri në pah përpjekjet për fuqizimin e komuniteteve rinore joshumicë në veri të Kosovës. Mbështetur nga projekti “Human Rightivism” i CDF dhe SIDA, ngjarja theksoi pjesëmarrjen e të rinjve në avokim dhe përfshirje sociale.

## TAKIMI KONSULTATIV PËR PROJEKTLIGJIN PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Më 17 tetor, ACDC dhe YIHR Kosovë organizuan takim konsultativ në Hotel Sirius në Prishtinë për të diskutuar Projektligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky takim mbledhi anëtarët e shoqërisë civile për të adresuar sfidat aktuale dhe për të ofruar komente për përafrimin e ligjit me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht për mbrojtjen e grupeve të cënueshme dhe minoritare. Vështrimet gjatë takimit do të kontribuojnë në ndryshimet e ardhshme ligjore nga grupi i punës.





## # ECOUNITY - FUQIZIMI I GRAVE DHE TË RINJVE PËR DREJTËSINË MJEDISORE NË VERIUN E KOSOVËS



Me mbështetjen e UNDP-së dhe në bashkëpunim me Education Code, ACDC filloi punëtoritë mbi drejtësinë mjedisore që u fokusuan në të drejtat mjedisore, praktikat e qëndrueshme dhe kornizat ligjore, duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve multi-etnike për të trajtuar së bashku sfidat mjedisore.



Më 1 tetor në Leposaviq u mbajt takimi avokues për adresimin e çështjeve kyçe të drejtësisë mjedisore si sfidat lokale dhe zgjidhjet e mundshme.




### ACDC PUBLIKON ARTIKUJ MBI MONITORIMIN E KRIMEVE TË LUFTËS

OJQ ACDC ka publikuar tri artikuj të rinj në kuadër të projektit "Lehtësimi i bashkëpunimit ndëretnik përmes monitorimit dhe raportimit të rasteve të krimeve të luftës". E udhëhequr nga Internews Kosova në partneritet me ACDC, kjo nismë synon të kontribuojë në drejtësinë tranzicionale duke dokumentuar seancat gjyqësore të krimeve të luftës në Kosovë dhe duke rritur ndërgjegjësimin si tek institucionet gjyqësore ashtu edhe tek publiku i gjerë.

 [ENG](#)

 [SRB](#)

 [ALB](#)

### PROJEKT I RI

Këtë muaj, ACDC filloi një projekt të ri të mbështetur nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) që synon rritjen e mbrojtjes ligjore dhe inkurajimin e angazhimit qytetar për komunitetet joshumicë të Kosovës. Ky projekt synon të adresojë boshllëqet ligjore që prekin komunitetet joshumicë në Kosovë.

## TRAJNIM I ODIHR



Slllobdan Stoshiq, Menaxher i Programit në OJQ ACDC, mori pjesë në trajnimin e organizuar nga ODIHR i mbajtur nga 29 deri më 31 tetor në Beograd. Trajnimi u fokusua në përdorimin e teknologjive të reja në kontrollin e kufijve dhe menaxhimin e migracionit, veçanërisht për mbrojtësit e të drejtave të njeriut që punojnë në kufijtë ndërkombëtarë në Evropën Juglindore.

## TAKIMI ME AP TË SHBA KASANOF



Aleksandar Rapajiq, Drejtor i Programit të OJQ ACDC, së bashku me përfaqësues nga OJQ të tjera, u takua me Zëvendës Ndhimës Sekretarin për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof, gjatë vizitës së tij në Kosovë për të diskutuar peizazhin politik, situatën në veri të Kosovës dhe shqetësimet e komunitetit.

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI ME SHOQËRINË E AVOKATËVE



15 tetor 2024: ACDC nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Shoqatën e Avokatëve, duke synuar veprime bashkëpunuese në politikat publike, të drejtat e njeriut dhe iniciativat për sundimin e ligjit.

## PANELI I MEDIAVE



Më 16 tetor, Drejtori Ekzekutiv i OJQ ACDC Dushan Radakoviq, i'u bashkua një paneli të organizuar nga ATRC që diskutonte rolin e medias në fuqizimin e grave, të rinjve dhe grupeve vulnerabël.





## DEKLARATA PËR MEDIE MBI SJELLJEN DHE PËRGJEGJËSINË E POLICISË



[SRB](#)



[ENG](#)



[ALB](#)

Në tetor, ACDC publikoi njoftime për shtyp duke theksuar shqetësimet në lidhje me sjelljen e Policisë së Kosovës. Çështjet kryesore përfshinin ndalimin e liderit të Demokracisë Serbe Aleksandar Arsenijević, gjatë një proteste paqësore, të cilën OJQ-të e dënuan si një kufizim politik të motivuar në lirinë e fjalës. Përveç kësaj, së bashku me OJQ-të e tjera, ne kërkuam llogari në lidhje me arrestimin e Policisë së Kosovës dhe keqtrajtimit e raportuar të Millosh Subotiqit, një qytetar i Mitrovicës së Veriut, duke i kërkuar EULEX-it dhe organizatave ndërkombëtare që të hetojnë dhe të sigurojnë transparencë.

ACDC, së bashku me Aktiv, CASA, NSI dhe InTed, kërkuan gjithashtu dorëheqjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, Atiq, duke kritikuar heshtjen e tij pas keqtrajtimit të Subotiqit dhe portretizimit të tij të grupeve të shoqërisë civile si kundërshtarë. Organizatat kanë kërkuar nga EULEX dhe misionet e tjera ndërkombëtare të ndërmarrin hapa konkretë në hetimin e këtij rasti dhe të sigurojnë përgjegjësinë e policisë.

Për të adresuar këto shqetësime, ACDC, krahas organizatave të tjera të shoqërisë civile, mbajti një takim me Avokatin e Popullit të Kosovës, Naim Qelaj. Gjatë diskutimit, përfaqësuesit ngritën çështje në lidhje me modelet e forcës së tepruar, sulmet verbale nga zyrtarët vendorë dhe qeveritarë ndaj anëtarëve të shoqërisë civile dhe nevojën urgjente për hetim efektiv.



ACDC në media

*Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i ACDC-së, ka folur për Kosova Online për raportin e UNMIK-ut për situatën në Kosovë, të prezantuar gjatë seancës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.*



*Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i ACDC, foli në TV Most për rënien e sigurisë publike në veri të Kosovës, duke u fokusuar në rritjen e incidenteve të ngacmimeve seksuale që targetojnë gratë.*



*Dushan Radaković, Drejtor Ekzekutiv i OJQ ACDC, u shfaq si mysafir në emisionin "Podglavlje" në RTK 2, ku diskutoi për promovimin e kohezionit social në Kosovë.*

